



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE INF.SJP-A

Nr. 876 Prot

Tiranë, më 19.05.2025

URDHËR

Nr. 57, datë 14.05.2025

**PËR KRYERJEN E LEJES VJETORE TË VITIT 2025 PËR STRUKTURAT
AKADEMIKE DHE NDIHMËSAKADEMIKE TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Mbështetur në nenin 92 dhe 93 të ligjit nr. 7961, datë 12.07. 1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, në nenin 39, pika 5 të ligjit “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 10 të Vendimit nr. 329, datë 12.04.2017 të Këshillit të Ministrave “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”, në Udhëzimin nr. 27, datë 29.12.2017 për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë si dhe në Statutin e Universitetit të Arteve, në cilësinë e titullarit të institucionit,

URDHËROJ:

1. Miratimin e datave për kryerjen e lejes vjetore për personelin ndihmësakademik në Universitetin e Arteve, nga data 7 Korrik 2025, deri më 10 Gusht 2025.
 - Data e paraqitjes në punë për personelin ndihmësakademik është 11 Gusht 2025.
2. Miratimin e datave për kryerjen e lejes vjetore për personelin akademik të Universitetit të Arteve, nga data 7 Korrik 2025, deri më 17 Gusht 2025.
 - Data e paraqitjes në punë për personelin akademik është 18 Gusht 2025.
3. Personeli akademik, deri më datë 7 Korrik (që përkon me ditën e parë të fillimit të lejes), duhet të ketë plotësuar këto detyrime: provime, procesverbale, evidenca të ngarkesave mësimore dhe çdo dokumentacion tjetër të detyrueshëm për t’u plotësuar dhe për t’u

dorëzuar në strukturat përkatëse apo çdo detyrim tjetër që mund të ketë në njësinë përkatëse apo në institucion.

4. Anëtarët e personelit akademik dhe ndihmësakademik, që për arsye pune ndërpresin lejen vjetore me urdhër të Rektorit, do ta vijojnë lejen vjetore sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
5. Anëtarëve të personelit akademik dhe ndihmësakademik, të cilët kanë shfrytëzuar disa ditë të lejes vjetore të vitit 2025 me urdhër të titullarit deri në momentin e daljes së këtij urdhri, do t'u zbriten përkatësisht këto ditë nga kuota e lejes vjetore për vitin 2025.
6. Anëtarët e personelit ndihmësakademik, të cilët me kërkesë pranë DMBNJI.SJP-A, deri më 30 Qershor 2025, rezervojnë një pjesë të kuotës së lejes vjetore të vitit 2025 për ta shfrytëzuar deri më 31 Mars 2026, do t'u zbriten ditët përkatëse nga kuota e lejes vjetore për vitin 2025.
7. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Inf.SJP-A, të marrë masat për zbatimin e pikave 5 dhe 6 të këtij urdhri.
8. Administratori i UART të marrë masat për urdhërimin e strukturës administrative për kryerjen e lejes vjetore.
9. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Drejtoria Ekonomike & e Investimeve, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Inf.SJP-A dhe Fakultetet e Universitetit të Arteve.
10. Ky urdhër të publikohet në faqen zyrtare të UART.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Erald Bakalli

